

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TEPELENË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Tepelenë me objekt: Menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm; Hartimin dhe zbatimin e buxhetit të bashkisë; Zbatimin të dispozitave ligjore që rregullojnë mërrëdhëniet e punës; Organizimit, mbajtjes së kontabilitetit, nxjerrjes së llogarisë vjetore, inventarizimit të pasurisë publike dhe administrimit dhe dokumentimit të vlerave monetare dhe materiale; prokurimit të fondeve publike; Realizimit të ardhurave dhe tarifave vendore; Në fushën e urbanistikës; Administrimit të aseteve dhe procedurës së dhënies me qira të tyre; Organizimit dhe funksionimit të inspektoriatit ndërtimor urbanistik; Organizimit e funksionimit të policisë bashkiake si dhe Zbatimin të strukturës organizative, nivelit të pagave dhe prokurimeve me vlera të vogla në Qendrën Kulturore dhe në Klubin e Sportit”, dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 109, datë 30.6.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 416/7, datë 30.6.2012, dërguar **z. Tërmet PEÇI**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Për të krijuar një mjedis të afirmuar kontrolli të brendshëm si dhe një siguri të arsyeshme që transaksionet janë në përputhje me parimet e mirë menaxhimit financiar, të transparencës, efijencës, efektivitetit dhe ekonomisë, të hartohet dhe të miratohet një rregullore organizative e brendshme përshtatur me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Menjëherë

2. Të bëhet një program sa më real i të ardhurave në veçanti i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe mbajtja e një dokumentacioni sa më të plotë.

Vazhdimisht

3. Të merren masat e duhura për realizimin e objektivave, veçanërisht për realizimin e taksave dhe tarifave vendore, duke hartuar programe të veçanta pune, duke ushtruar kontrole tatimorë në subjektet private në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, duke bërë analiza periodike dhe duke informuar vazhdimisht këshillin e bashkisë me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përcaktimin e përgjegjësive duke ndikuar dhe përmirësuar treguesit në vazhdimësi.

Vazhdimisht

4. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik të marrë masat për gjitha rastet kur subjektet ndërtuese nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në fushën e ndërtimit dhe të planifikimit të territorit që:

-Të vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe të planifikimit të territorit;

-Të paraqesë pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje licence profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;

-Të vendosë prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

-Të përgatisë kallëzimin penal gjatë ushtrimit të kontrollit, që ti paraqesë ato pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Vazhdimisht

5. Kryeinspektori INU-së në bashkëpunim me Sektorin e Financës të kërkojë arkëtimin e gjobave të vendosura, për të gjithë investitorët ndërtimor. Kryeinspektori INU-së të pezullojë punimet e ndërtimit për të gjithë rastet, deri në pagesën e plotë të tyre.

Vazhdimisht

6. Të merren masa për arkëtimin e vlerës **151,776 lekë** si e ardhur e munguar nga 5 subjekte, të cilët nuk kanë paguar kamat vonesat nga data e zbardhjes së lejeve të ndërtimit me datën e pagesës për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Deri më 31.12.2012.

7. Mbështetur në kërkesat e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të hiqet nga detyra e kontabilistit në Klubin e Futbollit, punonjësi ■■■ me detyrë N/kryetar bashkie dhe P/zyrës së financës në bashki, si dhe nga detyra e kontabilistes në Qendren Kulturore, punonjësjë ■■■, me detyrë Specialiste në zyrën e financës në bashki.

Menjëherë

8. Të përfshihet në strukturën organizative të administratës të bashkisë, pozicioni i Specialistit/es të Protokoll-Arkivës.

Menjëherë

9. Ngarkohet Bashkia që për ish nëpunësit e larguar nga puna të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, në rastin kur mos ushtrimi i detyrës administrative nga ana e tyre, ka ndikuar në funksionimin administrativ të bashkisë, mbështetur kjo në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Të kërkojen në rrugë ligjore dëmet ekonomike në vlerën totale **1,755,385 lekë**, të shkaktuara buxhetit të shtetit nga ku:

B.1. Për vlerën **190,000 lekë** në ngarkim të 2 punonjësve për përballimin e shpenzimeve të telefonisë së lëvizshme në kundërshtim me kërkesat e pikës 2 të VKM nr.343, datë 11.7.2002 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e pikës 8 (Lidhja nr.6) dhe pikës 10 e 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010.

Deri më 31.12.2012.

B.2. Për vlerën **586,465 lekë** në ngarkim të 3 punonjësve, për dëmin ekonomik të krijuar si rezultat i emërimit në detyrën e sekretares të kryetarit të bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e paragrafit të tretë, pika 11, Lidhja nr.2 “Nivelet e pagave për nëpunësit civil të bashkive tjera, njesitë bashkiake të Tiranës e nëpunësit e komunave” dhe kolona 7 “Njesi qeverisjes vendore 5001 deri 20000 banorë të VKM nr.1619, datë 2.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njesive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Deri më 31.12.2012.

B.3. Për vlerën **444,433 lekë**, në ngarkim të 7 punonjësve për dhënie page në kundërshtim me kërkesat e pikës 17 të VKM nr.1619, datë 2.7.2008.

Deri më 31.12.2012.

B.4. Për vlerën **113,532 lekë**, në ngarkim të 2 punonjësve për dhënie shtesë mbi pagë në kundërshtim me VKB nr.6, datë 11.02.2011 dhe të pikës 5 “Koha normale e punës” të Kontratës individuale të punës.

Deri më 31.12.2012.

B.5. Për vlerën **190,545 lekë**, në ngarkim të operatorit ekonomik fitues OJF [REDAKTUAR], sepse në prokurimin me objekt **“Qendër ditore për rehabilitimin dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuar”**, ka llogaritur gabim shpenzimet për pagë dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore të personelit që do kryejë shërbimin.

Deri më 31.12.2012.

B.6. Për vlerën **230,410 lekë (pa t.v.sh)**, në ngarkim të bashkimit të operatorëve ekonomikë, [REDAKTUAR], pasi nga kontrolli i dokumentacionit teknik të zbatimit i administruar në dosjen teknike dhe nga matjet në vend, u konstatuan diferenca në zëra e volume të pakryera në fakt, për objektin: **“Rrjeti i ujësjellsit nga Depoja e qytetit Lagjia Demokracia-Majkosh-Zona Industriale”- Tepelenë,**

Deri më 31.12.2012.

C. MASA ADMINISTRATIVE.

C.I. Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16 dhe ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, Bashkia Tepelenë të kërkojë nga Kryinspektori i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë, tu vendoset gjobë mbikëqyrëses dhe kolaudatorit të punimeve të ndërtimit, sepse: Veprimet e kryera prej tyre bien në kundërshtim me nenin 4, paragrafi parë, Kreu II-të, neni 7 paragrafi tretë, neni 8 paragrafi dytë, neni 9 paragrafi tretë shkronja “c” dhe neni 12 paragrafi parë pikat 1,2,3 dhe 4 të Kreut III-të, të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Mbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; me piken 4 paragrafi tretë, pika 5/c dhe 15 paragrafi i dytë, pika 17 dhe 19 të Kreut I-rë, pikat 3/a, 3/b dhe 3/c të Kreut II-të të UKM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe pikat 3/4, 7, 7/1 dhe 7/3 Kreu I-rë dhe pikat 2, 2/1 dhe 4 të Kreut III-të të UKM nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe përkatësisht

a. [REDAKTUAR] në cilësinë e mbikëqyrëses të punimeve në objektin “Rrjeti i ujësjellsit nga Depoja e qytetit Lagjia Demokracia-Majkosh-Zona Industriale”-Tepelenë, **gjobë në masën 50,000 lekë**, për dëmin ekonomik në vlerën 230,410 lekë sepse:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën totale **230,410 lekë.**

b. [REDAKTUAR] në cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektin “Rrjeti i ujësjellsit nga Depoja e qytetit Lagjia Demokracia-Majkosh-Zona Industriale”-Tepelenë, **gjobë në masën 500,000 lekë**, për dëmin ekonomik në vlerën 230,410 lekë sepse:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën totale **230,410 lekë.**

D. MASA DISIPLINORE.

D.1. Mbështetur në Kreun VIII-të “Masat Disiplinore”, neni 25, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, në pikat 1 e 2 të VKM nr.306, datë 13.06.2000 “Për Disiplinën në Shërbimin Civil”, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë, dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

“Vërejtje me Paralajmërim”, neni 25, pika 3, shkronja ”b”

1. Për zj. [REDAKTUAR] me detyrë P/Zyrës Juridike dhe me cilësinë e juristes në njesinë e prokurimit, për të metat e konstatuara si më poshtë:

-Në detyrën e P/Zyrës Juridike, ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën **586,465 lekë**, për përfshirjen në strukturat organizative të bashkisë të pozicionit të Sekretarit të Kryetarit të Bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e paragrafit të tretë të pikës 11 të lidhjes nr. 2 “Nivelet e pagave për nëpunësit civil të bashkive të tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe nëpunësit e komunave”, kolona 7 “Njësitë qeverisjes vendore 5001-20000 banorë” të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

-Në detyrën e P/Zyrës Juridike, ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën **444,433 lekë**, që përfaqëson shpenzime për pagë të dhënë disa punonjësve për vitin 2010 e 2011 në kundërshtim me kërkesat e pikës 17 të VKM nr.1619, datë 02.7.2008, i ndryshuar.

-Në cilësinë e juristes të njesisë së prokurimit në 3 (tre) tendera me vlerë totale të fondit limit prej **24,776 mijë lekë** u konstatuan shkelje gjatë procesit të përgatitjes së DT në këto drejtime:

-Urdhri e prokurimit nuk është hartuar në përputhje me Kreun II-të, pika 2 shkronja “a” dhe Kreun V-të, pika 1 shkronja “a” dhe “ç” të VKM nr.1, datë 10.01.2007,;

-Procesverbali për miratimin e DT, nuk është hartuar siç përcaktohet në Kreun V-të pika 2 shkronja “a”, të VKM nr.1, datë 10.01.2007;

-Gjithashtu në pikën 2 Kriteret e veçanta të kualifikimit, pjesa Kriteret specifike të kualifikimit, shkronja “b” “Licenca profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës”, ka mospërputhje në mes kërkesave për kategoritë e kërkuara të licencës të operatorit ekonomik, me zërat e punimeve të ndërtimit që janë në preventiv.

-Urdhri për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, nuk është në përputhje me Kreun V-të, pika 2, shkronja “ç” të VKM nr.1, datë 10.01.2007;

-Mungon procesverbali për përcaktimin e të paktën 5 operatorëve ekonomikë, të cilëve do ju dërgohet ftesa për marrjen e propozimeve, kërkesë kjo e Kreut VI-të, pika 1, shkronja “b” të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

“Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, shkronja ”a”

1. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë Zv/Kryetar i bashkisë dhe P/ Zyrës të Financës për të metat e konstatuara si më poshtë:

-Në detyrën e P/Zyrës të Financës, ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën **444,433 lekë**, që përfaqëson shpenzime për pagë të dhënë disa punonjësve për vitin 2010 e 2011 në kundërshtim me kërkesat e pikës 17 të VKM nr.1619, datë 02.7.2008, i ndryshuar.

2. Për zj. [REDAKTUAR] me detyrë specialiste në Zyrën e Financës, për të metat e konstatuara si më poshtë:

-Në detyrën e specialistes të financës, që mbulon pagat, ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën **113,532 lekë**, që përfaqëson shpenzime për pagë të dhënë më tepër 2 punonjësve të konviktit për vitin 2011, në kundërshtim me VKB nr.6, datë 11.02.2011 dhe pikën 5 “Koha normale e punës” të Kontratës Individuale të Punës.

3. Për zj. [REDAKTUAR] me detyrë audituese, për të metat e konstatuara si më poshtë:

-Gjatë vitit 2011 në kryerjen e auditimeve të institucioneve të varësisë dhe zyrave të bashkisë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9720, datë 23.4.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, si dhe “Manuali i Procedurave të Auditimit”, i miratuar me VKM nr.345, datë 01.6.2004.

4. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë P/Zyrës së Urbanistikës i komanduar dhe me cilësinë e anëtarit të njesisë së prokurimit, për të metat e konstatua si më poshtë:

-Në cilësinë e anëtarit të njesisë së prokurimit në 3(tre) tendera me vlerë totale të fondit limit prej **24,776 mijë lekë** u konstatuan shkelje gjatë procesit të përgatitjes së DT në këto drejtime:

- Urdhri e prokurimit nuk është hartuar në përputhje me Kreun II-të, pika 2 shkronja “a” dhe Kreun V-të, pika 1 shkronja “a” dhe “ç” të VKM nr.1, datë 10.01.2007,;
- Procesverbali për miratimin e DT, nuk është hartuar siç përcaktohet në Kreun V-të pika 2 shkronja “a” , të VKM nr.1, datë 10.01.2007. Gjithashtu në pikën 2 Kriteret e veçanta të kualifikimit, pjesa Kriteret specifike të kualifikimit, shkronja “b” “Licenca profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës”, ka mospërputhje në mes kërkesave për kategoritë e kërkuara të liçencës të operatorit ekonomik, me zërat e punimeve të ndërtimit që janë në preventiv.
- Urdhri për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, nuk është në përputhje me Kreun V-të, pika 2, shkronja “ç” të VKM nr.1, datë 10.01.2007;
- Mungon procesverbali për përcaktimin e të paktën 5 operatorëve ekonomikë, të cilëve do ju dërgohet ftesa për marrjen e propozimeve, kërkesë kjo e Kreut VI-të, pika 1, shkronja “b” të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatos Gjyzezi, Ramadan Zejnuni dhe Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT